

LICENCË PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMISIONIT (ME KUSHTE)

DHËNË:

***"KOSTT-OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMISIONIT DHE TREGUT" SH.A***

Numri i Regjistrimit: ZRRE_Li_15/06

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I	TERMAT E LICENCËS.....	3
PJESA II	KUSHTET E LICENCËS.....	3
Neni 1:	Përkufizimet dhe interpretimet	3
Neni 2:	Llogaritë e Ndara për Bizneset e Licencuara	5
Neni 3:	Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-Subvencioneve	6
Neni 4:	Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit Elektrik, Kodin Matës.....	6
Neni 5:	Operimi i Sistemit të Transmisionit	7
Neni 6:	Plani Zhvillimor	7
Neni 7:	Zotimi i Infrastrukturës	7
Neni 8:	Balanci i Energjisë	7
Neni 9:	Disponueshmëria dhe Mirëmbajtja e të dhënave	8
Neni 10:	Ndërlidhësit	8
Neni 11:	Operimi i Sistemit	9
Neni 12:	Blerja Ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndhmëse	10
Neni 13:	Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante ³³	10
Neni 14:	Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit	11
Neni 15:	Standardet Operuese të Sigurisë	11
Neni 16:	Standardet e Përgjithshme dhe Minimale gjatë Përmbushjes të Bizneseve të Operatorit të Transmisionit	12
Neni 17:	Qasja në Tokë dhe /ose në Ndërtesa	12
Neni 18:	Kufizimi në Përdorimin e Informacionit Përkatës	13
Neni 19:	Sigurimi i Informacioneve për Operatorët e tjerë të Sistemit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.....	13
Neni 20:	Kodi i Sjelljes së Operatorit të Sistemit të Transmisionit.....	14
Neni 21:	Rregullat e Tregut	14
Neni 22:	Shëndeti dhe Siguria	14
Neni 23:	Puna	14
Neni 24:	Obligimi i Sigurimit	14
Neni 25:	Ndryshimi në kontrollin e të Licencuarit	15
Neni 26:	Shërbimet Publike të Detyrueshme	15
Neni 27:	Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së	15
Neni 28:	Arsyet për përfundimin, tërheqjen dhe modifikimin e licencës	16
Neni 29:	Masat dhe Gjobat Administrative.....	17
Neni 30:	Zgjidhja e Kontesteve.....	17

Shtojca 1- Përshkrimi i karakteristikave të sistemit të transmisionit

Shtojca 2- Informacionet për linjat e ndërlidhjes

Shtojca 3- Informacione mbi pronësinë e elementeve të sistemit

PJESA I TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje “ZRRE”)**, në ushtrim të autoritetit të dhënë prej Neneve 15.2 (a), 28.2 (h) dhe Nenit 37 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji 2004/9) dhe Nenit 16.2 të Ligjit për Energjinë (Ligji 2004/8), dhe Neneve 12-16 të Kapitullit 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji 2004/10), me anë të kësaj, i lëshon: **KOSTT- OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT SH.A.**, i caktuar nga Qeveria e Kosovës, sipas Nenit 12.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (tani e tutje "i Licencuari") **licencë për transmision të energjisë elektrike** gjatë periudhës së specifikuar në paragrafin 6, sipas Neneve dhe kushteve të nxjerra në Pjesën II .
2. Sipas Nenit 32.1 (a) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, territori i mbuluar prej kësaj Licence është i tërë territori i Kosovës (tani e tutje "Territori").
3. Në pajtim me Nenin 32.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të Licencuarit mund të mos i jepet licenca për prodhim, shpërndarje, furnizim apo tregti të energjisë elektrike apo për prodhim të ngrohjes qendrore.
4. I Licencuari do të veproj në përputhje me të gjitha Nenet dhe kushtet e përcaktuara me këtë licencë për ushtrimin e aktivitetit të licencuar, dhe me kriteret e të gjithë legjislacionit përkatës dhe urdhëresave të ZRRE-së, dhe duke vepruar kështu, do të përpiqet gjatë çdo kohe, që të veproj në pajtueshmëri me:
 - a) kryerjen me efikasitet të detyrimeve që ja imponon kjo licencë;
 - b) operimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar nga ana e të Licencuarit të sistemit të transmisionit të tij;
 - c) promovimin e konkurrencës efektive në gjenerimin dhe furnizimin me energji elektrike, dhe (nëse është e përshtatshme) promovimin e kësaj konkurrence për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
 - d) promovimin e efikasitetit në zbatimin dhe administrimin e balancimit dhe llogaritjeve përfundimtare të përcaktuara prej Rregullave të Tregut.
5. Nenet dhe kushtet e kësaj licence i nënshtrohen modifikimit ose përfundimit, ose anulimit (tërheqjes) në përputhje me termat e tyre dhe me Nenet 35, 36, 37 dhe 39 të Rregullit për Liçencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
6. Kjo licencë do të hyjë në fuqi më 04 Tetor 2006 dhe përveçse në rast se tërhiqet, do të vazhdojë të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare, deri më 04 Tetor 2036 me mundësi vazhdimi sipas Rregullit për Liçencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji më: _____.

Nënshkruar (në emër të Bordit të ZRRE-së): _____

PJESA II KUSHTET E LICENCËS

Neni 1: Përkufizimet dhe interpretimet

1. Për qëllim të kësaj licence, termat dhe shprehjet e renditura më poshtë, do të kenë kuptimin vijues:

"Anëtar" nënkupton në marrëdhënie të drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo Kompani Aksionare apo Vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një Kompanie Aksionare të të Licencuarit, në secilin rast brenda kuptimit të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

"Shërbime ndihmëse" ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe në Kodin e Rrjetit Elektrik.

"Programi i Pajtueshmërisë" është programi i kërkuar që të përgatitet nga ana e të licencuarit dhe që do të aprovohet nga ZRRE-ja, sipas Nenit 12.3 (d) të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Kodi i Shpërndarjes" nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

"Sistemi i Shpërndarjes" ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Plani Zhvillimor" nënkupton çdo plan zhvillimor që do të përgatitet prej të Licencuarit, sipas Nenit 8 të Ligjit për Energjinë.

"Ndërmarrje për energjinë elektrike" ka kuptimin e dhënë sipas Nenit 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Vit financiar" është periudha prej 1 Janarit deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

"Deklaratë parashikuese " nënkupton bilancet energjetike afatgjate dhe ata vjetorë për energjinë elektrike, që do t'i propozohen Ministrisë së Energjisë dhe Minierave nga i licencuari, pas konsultimit me ZRRE-në, sipas Nenit 6 të Ligjit për Energjinë dhe në përputhje me Kodin e Rrjetit Elektrik.

"Kodi i Rrjetit Elektrik" nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit sipas Ligjit të Energjisë Elektrike aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

"Kompani Aksionare" nënkupton çdo kompani e definuar si e tillë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

"Legjislacion" nënkupton Ligjin për Energjinë (2004/8), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (2004/9), Ligji për Energjinë Elektrike (2004/10) dhe legjislacioni tjetër parësor ose dytësor që do të nxirret për të ekzekutuar legjislacionin parësor në rregullimin e sektorit të energjisë.

"Operatori i Tregut" nënkupton një person juridik që është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtisë së energjisë elektrike dhe marrëveshjet për pagesë midis gjeneruesve,

furnizuesve dhe konsumatorëve.

“Rregullat e Tregut” nënkuptojnë grup rregullash të miratuara nga ZRRE që udhëheqin tregtinë e energjisë midis Operatorit të Tregut dhe ndërmarrjeve tjera të energjisë elektrike, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit, me qëllim të mirëmbajtjes së balancës fizike të tregut. Kjo përfshinë çdo marrëveshje kalimtare mbi tregtimin që do të mund të aprovohej nga ZRRE-ja.

“Kodi Matës” nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit sipas Ligjit për Energji Elektrike aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

“Pajisjet Matëse” janë pajisjet dhe instalimet në një Sistem Matjeje që është specifikuar në Kodin Matës se mjafton të ofron të dhëna matjeje që kërkohen sipas Rregullave të Tregut.

“Sistemi i Matjes” nënkupton grumbull njehsorësh të regjistruar të trajtuar si një njehsim (lexim) i veçantë për Llogaritje përfundimtare siç parashihet me Kodin e Matjes.

“Modifikim” përfshin shtimin, ndryshimin dhe zëvendësimin, dhe shprehjet e përafërta që do të shpjegohen në përputhje me rrethanat.

“Standardet e Sigurisë për Operim” nënkuptojnë dokumentet që do të përgatiten nga i Licencuari, në përputhje me Nenin 16 të licencës.

“Marrëveshje për blerjen e energjisë ” nënkupton marrëveshja që i referohet Nenit 21.3 të Ligjit për Energjinë elektrike.

“Vartës” nënkupton çdo kompani në pronësi apo e kontrolluar nga një kompani tjetër, e që definohet sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

“Furnizues” nënkupton personin juridik të licencuar sipas dispozitave të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë për të bërë furnizimin me energji elektrike siç definohet sipas Nenit 20 të Ligjit për Energji Elektrike.

“Sistemi i Transmisionit” nënkupton sistemin e transmisionit, sipas Nenit 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

“Operatori i Sistemit të Transmisionit” nënkupton Operatorin e Sistemit të Transmisionit, sipas Nenit 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

“Standardet për Sigurinë e Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit” nënkupton dokumentin që do të përgatitet nga i Licencuari në përputhje me Nenin 15 të kësaj licence.

2. Termat e përdorur në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termat e përdorur në legjislacion.
3. Duke iu referuar paragrafit 2, çdo modifikim ose ri-dekretim (rishpallje) i legjislacionit pas datës kur kjo licencë hyn në fuqi, do të aplikohet.
4. Përveç nëse specifikohet ndryshe:

- a) çdo referencë në një Nen të numëruar ose në një Shtojcë të numëruar, është respektivisht një referencë në Nenin apo Shtojcën që mban atë numër në këtë licencë;
 - b) çdo reference në një paragraf të numëruar, është një reference në paragrafin që mban të njëjtin numër në Nenin ose në Shtojcën ku shfaqet referenca.
5. Titulli ose tema e ndonjë Pjese, Neni, Shtojce ose paragrafi, nuk do të ndikojë në kuptimin e saj.
 6. Kur të Licencuarit i imponohet për të kryer një detyrim brenda një afati të specifikuar, ai detyrim duhet të vazhdojë të jetë detyrues dhe në fuqi edhe pas atij afati kohor, pa marrë parasysh masat administrative dhe gjokat që mund t'i caktohen të Licencuarit, nëse i Licencuari nuk e kryen aktivitetin e duhur brenda afatit kohor.
 7. Dispozitat e paragrafit 6 do të aplikohen në çdo dokument që do të paraqitet ose, udhëzimi njoftimi dhe shërbimi që duhet të kryhet sipas kësaj licence dhe udhëzimeve të lëshuara prej ZRRE-së.

Neni 2: Llogaritë e Ndara për Bizneset e Licencuara

Kushti 1

Sipas Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë i Licencuari duhet të veprojë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e këtij Neni brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence.

1. I Licencuari do të përgatisë kontabilitetet vjetore rregullative në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, nxjerrë nga ZRRE-ja dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të kontabilitetit vjetor të revizionuar (audituar) përgatitur sa më shpejt që është e mundur, dhe i cili duhet të dorëzohet brenda tre (3) muaj, pas përfundimit të vitit financiar për të cilin kanë të bëjnë llogaritë.
2. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për bizneset e Operatorit të Sistemit të Transmisionit në tërsi (të ndarë nga biznesi i Operatorit të Tregut), e cila në rast se kërkohet nga ZRRE-ja, duhet t'i dorëzohet asaj në formën dhe datën e specifikuar nga ZRRE-ja. Kontabiliteti rregullativ do të mbahet në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, që nxirren kohë pas kohe nga ZRRE-ja.
3. Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet ose udhëzimet që ZRRE-ja i njofton të Licencuarit sipas paragrafit 2, ndër të tjerash mund të:
 - a) specifikojnë formën e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumatat e të ardhurave vjetore, kostove, asetëve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis bizneseve të konsoliduara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe ndonjë biznesi tjetër;
 - b) të specifikojë natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara;

- c) të specifikojë parimet e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse ZRRE-ja nxjerr më parë udhëzimet për qëllimet e këtij Neni ose nëse ZRRE-ja jep paraprakisht aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
 5. I Licencuari do të veproj plotësisht në përputhje me dispozitat e Nenit 12.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe do të ndër marr të gjitha masat e nevojshme që të veproj në përputhje me ato kërkesa me qëllim që të garantojë pavarësinë e tij.
 6. I Licencuari do të veproj në përputhje me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja e për qëllim të këtij Neni.

Neni 3: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-Subvencioneve

I Licencuari do të sigurojë se biznesi i licencuar nuk do të japë asnjë subvencion ose ndër-subvencion (direkt ose indirekt) dhe as nuk do të marrë asnjë subvencion ose ndër-subvencion (direkt ose indirekt) prej ndonjë biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartës apo ndërmarrje të lidhur me të, dhe/ose ndonjë personi tjetër.

Neni 4: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit Elektrik dhe Kodin Matës

Kushti 2

Në përputhje me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe pas konsultimeve me të Licencuarin, Gjeneratorin dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, ZRRE-ja mund ti jep të Licencuarit një udhëzim me një afat kohor specifik për implementimin e këtij Neni. Afati i tillë kohor mund të zbatohet dhe të ketë shtrirje në ato pjesë të Kodeve siç precizohet në atë udhëzim.

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Rrjetit Elektrik dhe Kodit Matës, për aq kohë sa janë të zbatueshëm.

Neni 5 : Operimi i Sistemit të Transmisionit

1. I Licencuari do të kryejë aktivitet efikas, ekonomik dhe të koordinuar në Sistemin e Transmisionit.
2. Dispozitat e Nenit 11 të Ligjit për Energjinë, Rregulli mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë dhe Metodologjisë së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike të miratuar nga ZRRE-ja, Nenet 13, 14, 25, 26, 30 dhe 31 të Ligjit për Energjinë Elektrike, dhe Kodit të Rrjetit Elektrik dhe të Shpërndarjes, do të aplikohen tek i Licencuari.
3. I Licencuari mban detyrimin për të ofruar kushtet për lidhjen në rrjet dhe shfrytëzimin e sistemit të tij sipas Rregullit për Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me Energji dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të paraqitet në lidhje me shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit, do të aplikohet Rregulli mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, miratuar nga ZRRE-ja.

4. I Licencuari do të siguroj qasje jo diskriminuuese në mes të shfrytëzuesve të sistemit ose klasave të shfrytëzuesve të sistemit, veçanërisht në favor të ndonjë vartësi apo aksionari dhe tu siguroj shfrytëzuesve të sistemit informatat që ju nevojiten për qasje efikase në sistem, e në përputhje me Nenin 18.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
5. Në përcaktimin e tarifave dhe pagesave për kyçje si dhe shfrytëzimin e sistemit të transmisionit, i Licencuari do të siguroj sinjale të caktuara dhe jo diskriminuuese lidhur me çmimet dhe të siguroj që tarifat dhe pagesat e tilla:
 - a) do të nxisin konkurrencën në sektorin e energjisë dhe do të lehtësojnë hyrjen në treg, dhe
 - b) do të jenë në përputhje me Metodologjinë e Tarifave në Sektorin e Energjisë.
6. I Licencuari do të jep sinjal real dhe të duhur që lehtëson qasjen e lirë në treg.
7. I Licencuari do të botojë dhe do të vendosë në faqen zyrtare elektronike të tij deklaratën mbi tarifat për lidhjen në rrjet dhe shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit, të aprovuar nga ZRRE-ja sipas Nenit 18 të Ligjit për Energjinë, Nenit 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Nenit 45 deri në 48, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 6: Plani Zhvillimor

1. Në përputhje me Nenin 8 të Ligjit për Energjinë dhe Nenit 24.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, i Licencuari do të përgatis, nxjerr dhe publikoj planin zhvillimor të Sistemit të Transmisionit për tri (3) vitet vijuese. Plani zhvillimor duhet të identifikoj mundësitë dhe limitet për përdorim dhe lidhje në sistem. Para publikimit plani duhet të dorëzohet në ZRRE për aprovim.
2. I Licencuari do të korrigojë planin zhvillimor çdo vit, në mënyrë që informacioni i paraqitur në planin zhvillimor të jetë i saktë në të gjithë aspektet materiale, dhe t'ia dorëzojë ZRRE-së për aprovim.

Neni 7: Zotimi i Infrastrukturës

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me zotimin e infrastrukturës që rrjedh prej Programit të Zbatimit të Strategjisë së miratuar nga Qeveria, ku për këtë qëllim janë vënë në dispozicion fondet përkatëse (ose përmes kontrollit të çmimit, ose përmes Qeverisë apo burimeve të tjera), si dhe zotimin e infrastrukturës të përcaktuar në Nenin 13.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
2. I Licencuari do të raportojë çdo vit në ZRRE mbi aktivitetet që do të kryhen prej tij, në lidhje me zotimin e infrastrukturës.

Neni 8: Bilanci i Energjisë

1. Pas konsultimit me ZRRE-në i Licencuari do të propozoi Ministrisë së Energjisë dhe Minierave bilancin afatgjatë dhe atë vjetor për energji elektrike në përputhje me Nenin 6 të Ligjit për Energji brenda afatit të përcaktuar në Rregullin për Bilancin e Energjisë.
2. I Licencuari do të botojë dhe do të vej në dispozicion në faqen zyrtare elektronike të tij propozimin për bilancin e energjisë, përveç informatave zbulimi i të cilave mund të tregonte që i Licencuari ka shkelur Nenin 19 të kësaj licence.

Neni 9: Disponueshmëria dhe Mirëmbajtja e të Dhënave

1. Në përputhje me Nenin 13.1 (f) të Ligjit për Energji Elektrike, i Licencuari do të siguroi që shfrytëzuesit aktual dhe ata potencial të sistemit të Transmisionit do të kenë qasje jo diskriminuese në informatat që atyre ju nevojiten për të pasur qasje efikase në sistem.
2. I licencuari do të marr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar dhe implementuar të gjitha detyrimet që dalin nga ose në lidhje me Legjislacionin e aplikueshëm, licencën aktuale dhe marrëveshjet ku ai është palë.
3. Duke ju referuar paragrafit 1 i Licencuari do të dorëzoi në ZRRE raport tremujor për biznesin e tij në operimin e Sistemit të Transmisionit dhe pajtueshmërisë me kushtet e licencës.
4. I Licencuari është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe publikimin e të dhënave të informacioneve për kapacitetet kufitare, në ndërlidhjet si dhe për të drejtat dhe detyrimet në lidhje me harduerin dhe softuerin e nevojshëm për kalkulimin e ngarkesës së rrjedhjes, menaxhimin e kongjestionit, planin e dispeçimit të kapacitetit, tregun balancues dhe atë ndihmës si dhe informatat tjera të ndërlidhura.
5. ZRRE-ja mund të kërkojë nga i Licencuari që të mbledh dhe mbaj informatat, të dhënat dhe dokumentet në përputhje me Nenin 31 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Neni 10: Ndërlidhësit

1. Në përputhje me nenin 13.1 (a) të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullave të Tregut, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj licence, i Licencuari do të përgatisë një procedurë për alokimin dhe shfrytëzimin e linjave ndërlidhëse me sisteme të tjera, e cila do t'i dorëzohet ZRRE-së për aprovim. Në momentin kur Rregullat Rajonale për alokimin e kapaciteteve transmetuese bëhen obligative, atëherë i Licencuari jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të tyre, duhet të përgatis procedurat relevante dhe t'i dorëzohet ZRRE-së për aprovim.
2. I Licencuari do të vlerësojë dhe zhvillojë mundësitë për të ndërlidhur Sistemin e Transmisionit me sistemet e tjera, sipas nevojave të regjionit do të përgatis çdo dy (2) vjet listën e kapaciteteve të reja të transmisionit dhe linjave ndërlidhëse të energjisë që kërkohen sipas nevojave të Kosovës dhe do të veproj në pajtim me çdo direktivë të ZRRE-së dhe dispozitë të rëndësishme të Legjislacionit.
3. Pas komisionimit të çdo linje ndërlidhëse, i Licencuari duhet të përgatisë një deklaratë për aprovim nga ZRRE-ja ,sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më vonë se në datën që ka përcaktuar ZRRE-ja, ku tregohen:
 - a) sasia totale e kapacitetit të çdo ndërlidhësi ose të të gjithë ndërlidhësve të parashikuar nga i Licencuari që do të jetë në dispozicion për transferimin në baza ditore të energjisë elektrike nga territori i veprimt të të Licencuarit tek Operatorët tjerë të Transmisionit jashtë territorit;
 - b) sasia e kapacitetit të çdo ndërlidhësi, që është propozuar për t'u rezervuar nga i Licencuari dhe/ose nga ndonjë operator tjetër sistemi për qëllime siç janë siguria e sistemit;

- c) çdo çështje që ZRRE-ja mund të specifikoi para aprovimit të deklaratës.
4. I Licencuari do të shqyrtojë në mënyrë të rregulltë kapacitetet ditore në disponim të paraqitura në deklaratën të cilës i është referuar në paragrafin 3, dhe në rast të modifikimit menjëherë ta dorëzoj deklaratën e modifikuar në ZRRE për aprovim.
 5. Deklarata nga paragrafi 3, do të botohet në faqen elektronike zyrtare të të Licencuarit.
 6. Për qëllime të këtij Neni:

“Rregullat Rajonale” nënkuptojnë rregullat sipas marrëveshjeve ndërkombëtare obliguese për alokimin e kapaciteteve transmetuese;

Neni 11: Operimi i Sistemit

1. I Licencuari do të nxjerrë udhëzime direkte për dispeçimin e të gjitha njësive të gjenerimit që janë në dispozicion të çdo gjeneruesi të rëndësishëm në territor, sipas programimit dhe njoftimit me shkrim të dhënë nga gjeneruesit dhe furnizuesit, dhe më pas i Licencuari do të kryejë mekanizmin balancues (kërkesë dhe furnizim) në përputhje me Rregullat e Tregut.
2. I Licencuari do të ndërmarr planifikim operativ dhe do të nxjerrë udhëzime direkte për dispeçin e këtyre njësive gjeneruese, duke marrë parasysh njoftimet me shkrim të referuara në paragrafin 1 dhe faktorët në vazhdim:
 - a) parashikimin e kërkesave;
 - b) kufizimet teknike të vendosur kohë pas kohe në të gjithë sistemin ose në ndonjë pjesë të tij;
 - c) karakteristikat e dinamikës operuese të njësive të prodhimit dhe transferit të linjës së ndërlidhjes;
 - d) parashikimet e eksporteve dhe importeve të energjisë elektrike përgjatë çdo linje të ndërlidhjes;
 - e) humbjet gjatë transmisionit;
 - f) ndërprerjet e sistemit të transmisionit për mirëmbajtje, riparim, zgjerim ose përforcim;
 - g) standardet Operuese të Sigurisë, të cilat janë referuar në Nenin 16 të kësaj Licence;
 - h) mekanizmit balancues në përputhje me Rregullin e Tregut;
 - i) dhënien e kapaciteteve të transmisionit në mënyrë jo diskriminuese;
 - j) energjia elektrike e dërguar në sistemin e transmisionit nga blloqet e gjenerimit që nuk i nënshtrohen dispeçimit qëndror; dhe
 - k) çështje të tjera që përcaktohen në Kodin e Rrjetit Elektrik.
3. Për dispeçimin e energjisë së prodhuar, i Licencuari do ti jap prioritet energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë siç lejohet me Kodin e Rrjetit dhe në përputhje me Nenin 11 të Ligjit për Energjinë.
4. I Licencuari do t’i japë ZRRE-së atë informacion që kërkon ZRRE-ja në lidhje me funksionimin e sistemit, ose ndonjë aspekt tjetër të funksionimit të vet.
- 5 Në këtë Nen:

“Transferim ndërlidhës” nënkupton rrjedhën e energjisë përgjatë një ndërlidhësi ashtu siç parashihet me Kodin e Rrjetit Elektrik.

Neni 12: Blerja Ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndhmëse

1. I Licencuari do të kontraktojë ose të bëjë të mundur sigurimin e asetëve dhe shërbimeve në ato sasi dhe në ato lloje të shërbimeve ndihmëse si nevojitet dhe është e përshtatshme për t'i mundësuar të Licencuarit që të kryejë detyrimin e tij në përputhje me legjislacionin përkatës të prokurimit që aplikohet në Kosovë dhe me Kodin e Rrjetit Elektrik.
2. Gjatë kontraktimit ose lidhjes së marrëveshjeve për sigurim të asetëve, shërbimeve dhe shërbimeve ndihmëse në përputhje me paragrafin 1, i Licencuari pa paragjykuar zotimin për infrastrukturë, do të blejë ose do të sigurojë ato asete, shërbime dhe shërbime ndihmëse nga burimet më ekonomike që ka në dispozicion.
3. Duke marrë parasysh burimet më ekonomike që ka në dispozicion, i Licencuari duhet të ketë parasysh sasinë, natyrën, shumëllojshmërinë, numrin dhe sigurinë e asetëve, shërbimeve dhe Shërbimeve Ndhmëse që janë në dispozicion për blerje ose për përvetësim tjetër, dhe sipas nevojave të tij të mundësojë atij që të kryejë obligimet e tija sipas Legjislacionit, Kodit të Shpërndarjes dhe kësaj licence.

Neni 13 Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante

1. I Licencuari do të përgatisë dhe do të mbajë regjistër të të gjithë asetëve të tij dhe do të dorëzojë në ZRRE këtë regjistër çdo vit jo më vonë se me 30 Janar të vitit të ardhshëm.
2. I Licencuari nuk do të tjetërsojë apo braktis kontrollin funksional mbi ndonjë aset përkatës, nëse kjo do të ndikonte në aftësinë e tij për të kryer detyrimet e tija, ose nëse asetet kanë vlerën zëvendësuese mbi 100,000.00 Euro.
3. Në rast kur i Licencuari kërkon që të tjetërsojë disa asete në pronësi apo në shfrytëzim, apo burimeve tjera në ushtrimin e veprimtarisë së licencuar, i Licencuari obligohet që ta njoftojë ZRRE-në me shkrim. I Licencuari mund ta bëjë tjetërsimin e ndonjë aseti vetëm pas miratimit me shkrim nga ana e ZRRE-së.
4. Dispozitat e përcaktuara me paragrafin 3 do të aplikohen edhe në rastin e heqjes së asetëve apo burimeve tjera që përdoren për ushtrimin e aktivitetit të licencuar.
5. Në këtë Nen:

"Tjetërsim" nënkupton shitjen, transferimin, dhurimin, dhënien me qira, licencë, hua, hipotekën, ngarkimin, kufizimin mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor), dhënien, vënien e ndonjë pengese tjetër, si dhe lejimin e ndonjë pengese ose ndonjë përdorim tjetër ndaj një Biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose pale të tretë, dhe "tjetërsimi" do të interpretohet në përputhje me rrethanat.

"Aset relevant" nënkupton:

- a) çdo pajisje e Sistemit të Transmisionit që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet e veta që përcaktohen nga kjo licencë,
- b) çdo interes ligjor ose përfitues mbi tokën dhe/ose ndërtesat në të cilat janë vendosur të sipërpërmendurit, dhe/ose që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet që përcaktohen nga kjo licencë; dhe
- c) ç'do e drejtë pronësore përkatëse intelektuale.

Neni 14: Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit

1. Jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj licence, i Licencuari duhet të krijojë Standardet për Sigurinë e Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit, dhe do të dorëzoj në ZRRE për aprovim. ZRRE-ja mund ta aprovoi zgjatjen e këtij afati si përgjigje për kërkesën e arsyetuar nga i Licencuari.
2. I Licencuari do të jetë përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes së Sistemit të Transmisionit, dhe nëse është e nevojshme, edhe zhvillimin e tij në përputhje me Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Standardeve të Planifikimit.
3. I Licencuari do të shqyrtojë periodikisht Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit dhe zbatimin e tyre. Pas këtij shqyrtimi, i Licencuari do të dërgojë në ZRRE për shqyrtim dhe miratim:
 - a) raport të rezultateve të këtij shqyrtimi; dhe
 - b) ndryshimet e propozuara që të bëhen në Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit.
4. ZRRE-ja mund të nxjerrë udhëzime që i kërkojnë të Licencuarit të rishikojë Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit, në atë mënyrë që është specifikuar në udhëzime, dhe i Licencuari duhet të bjerë në pajtim me ato udhëzime.
5. I Licencuari do të botojë dhe do t'i vërë Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit në dispozicion në faqen e tij elektronike zyrtare.

Neni 15: Standardet e Sigurisë së Operimit

1. I Licencuari, jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj licence, do të themeloj Standardet e Sigurisë së Operimit për të siguruar funksionimin e përditshëm të Sistemit të Transmisionit, dhe ti dërgoj ato në ZRRE për aprovim. ZRRE-ja mund të miratoj shtyrjen e këtij afati si përgjigje në kërkesën e të Licencuarit.
2. I Licencuari do të jetë përgjegjës për operimin e Sistemit të Transmisionit në përputhje me Standardet e Sigurisë së Operimit
3. I Licencuari do të shqyrtojë periodikisht Standardet e Sigurisë së Operimit dhe zbatimin e tyre. Pas shqyrtimit të tillë, i Licencuari do t'i dërgojë ZRRE-së:
 - a) një raport të rezultateve të këtij shqyrtimi; dhe
 - b) ndryshimet që është propozuar t'u bëjë Standardeve të Sigurisë së Operimit (duke pasur parasysh rezultatin e shqyrtimit).
4. ZRRE-ja mund të nxjerrë udhëzime me të cilat kërkon nga i Licencuari që ti ripunoj Standardet e Sigurisë së Operimit në atë mënyrë që do të specifikohet në ato udhëzime, dhe i Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me ato udhëzime.
5. I Licencuari do të botojë Standardet e Sigurisë së Operimit dhe do t'i vë ato në dispozicion në faqen e vet elektronike zyrtare.

Neni 16: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale gjatë Përbushjes së Bizneseve të Operimit të Transmisionit

1. I Licencuari do të udhëheq bizneset e operatorit të transmisionit në mënyrën më të përshtatshme për të arritur standardet e përgjithshme dhe minimale të përbushjes, propozuar nga ai dhe aprovuar nga ZRRE-ja kohë pas kohe.
2. Brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj licence, i Licencuari do ta përgatisë dhe t'ia dorëzojë ZRRE-së për aprovim propozimin e përbushjes së standardeve i cili do të:
 - a) identifikojë standardet e përbushjes së përgjithshme të cilat do të jetë i obligueshëm ti mbështesë;
 - b) paraqesë standardet minimale të përbushjes dhe kualitetin e shërbimit në lidhje me çështjet specifike të cilat do të jetë i obligueshëm ti mbështesë; dhe
 - c) specifikojë kompensimet financiare që do t'ua paguaj konsumatorëve në rast kur standardet minimale nuk janë në përputhje me nën-paragrafin b) dhe sipas marrëveshjes për Kyqje.
3. Gjate gjithë kohës KOSTT-i do te veproj si operator i arsyeshëm dhe i matur në pajtim me praktikat me te mira industriale
4. I Licencuari do të implementoj standardet e aprovuara dhe do t'i propozojë ZRRE-së për aprovim procedurat e monitorimit të pajtueshmërisë së të njëjtës. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.
5. I Licencuari do të rishqyrtojë dhe, nëse duhet, do të propozojë ndryshimet në standardet e aprovuara, dhe/ose procedurat e realizuara në përputhje me këtë Nen sipas udhëzimeve të ZRRE-së.
6. I Licencuari do t'i sigurojë ZRRE-së jo më vonë se 30 Prill të çdo viti raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet e performimit. Ky raport do të përfshijë aso informatash dhe analizash nëse këtë e kërkon ZRRE-ja kohë pas kohe me qëllim që të vendosë, nëse i Licencuari has apo jo në përbushjet e përgjithshme, standardet e përbushjes sipas këtij Neni.
7. I Licencuari jo më vonë se deri me 30 Prill të çdo viti do të publikojë statistikën në mënyrën që ZRRE-ja i kërkon me qëllim të identifikimit të shtrirjes dhe kryerjes apo moskryerjes së standardeve të performancës, të vendosura sipas këtij Neni.
8. I Licencuari në kryerjen e funksioneve të veta do të marrë parasysh qëllimin për të qenë objektiv dhe jo diskriminues në përputhje me Nenin 13.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike

Neni 17: Qasja në Tokë dhe /ose në Ndërtesa

1. Jo më vonë se tre (3) muaj pas lëshimit të kësaj Licence, i Licencuari do të përgatisë dhe dërgoi ZRRE-së për aprovim një Kod Pune ku përcaktohen parimet dhe procedurat që do të ndjekë në lidhje me ndonjë person që vepron në emër të të Licencuarit dhe që kërkon qasje në tokë dhe/ose ndërtesë e që lidhet me ushtrimin e biznesit të licencuar.

2. Kodi i Punës do të sigurojë procedurat e përlogaritura për të siguruar që personi që viziton tokën dhe/ose ndërtesën në emër të të Licencuarit:
 - a) posedon aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e kërkuara; dhe
 - b) mund të identifikohet nga publiku, dhe
 - c) janë persona të caktuar për të vizituar tokën dhe për të hyrë në të.
3. I Licencuari do të rishqyrtojë periodikisht këtë Kod Pune dhe çdo ndryshim i këtij Kodi Pune do t'i nënshtrohet aprovimit të ZRRE-së.
4. I Licencuari do të siguroj se vepron në pajtueshmëri me Kodin e Punës dhe me çdo ndryshim të tij siç aprovohet kohë pas kohe nga ZRRE-ja.

Neni 18: Kufizimi në Përdorimin e Informacionit përkatës

1. I Licencuari mund të zbulojë çdo informacion përveç atij që është i fshehtë, dhe që mbahet dhe/ose është fituar gjatë kryerjes së funksioneve të veta si Operator i Sistemit të Transmisionit siq definohet me Rregullin mbi Konfidencialitetin e Informatave të miratuar nga ZRRE. Kjo ndalesë nuk do ta pengoj të Licencuarin që ti zbuloj informatat ZRRE-së që kjo mund ti kërkoj në kryerjen e obligimeve që i janë dhënë me Legjislacion dhe Nenin 29 të kësaj licence.
2. I Licencuari do të sigurojë që çdo dokument që përmban informacione të fshehta do të shënohet si i tillë.
3. I Licencuari do të marrë masat për të parandaluar zbulimin e informacioneve të fshehta nga çdo person që është i punësuar tek i Licencuari ose që nuk vazhdon të jetë i punësuar prej tij.
4. I Licencuari do të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që informata e fshehtë nuk përdoret apo zbulohet për ndonjë qëllim tjetër nga ai për të cilin është dorëzuar në përputhje me dispozitat e Rregullit për Konfidencialitetin e Informatave.
5. Në këtë Nen:

“Informatë konfidenciale (e fshehtë)” është çdo informacion komercial ose tjetër dhe që mbahet dhe/ose është fituar nga i Licencuari gjatë kryerjes së detyrave të veta sipas Legjislacionit, dhe që do të konsiderohet si konfidenciale sipas Rregullit mbi Informatat Konfidenciale dhe kësaj licence.

Neni 19: Sigurimi i Informacioneve për Operatorët e tjerë të Sistemit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Në mënyrë që të sigurojë funksionim efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërfunksionimin e sistemeve të ndërlidhura, i Licencuari do t'i dërgojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorëve tjerë të Sistemit që janë të ndërlidhur, çdo informatë të domosdoshme në atë mënyrë dhe në ato kohë që me arsye mund të jetë kërkuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorët tjerë të Sistemit.
2. Për qëllimet e këtij Neni, në rast të paraqitjes së ndonjë kontesti në mes të të Licencuarit dhe ndonjë pale tjetër do të zbatohet Rregulli mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Neni 20: Kodi i Sjelljes së Operatorit të Sistemit të Transmisionit

1. I Licencuari do të përgatisë një Kod të Sjelljes dhe dërgoj ZRRE-së për aprovim brenda gjashtë (6) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence.
2. Kodi i Sjelljes do të zbatohet ndaj çdo të punësuarit të të Licencuarit.
3. Kodi i Sjelljes së Operatorit të Transmisionit do të mbulojë detyrimet e konfidencialitetit , konfliktet e interesave, dhe obligime tjera të ngjajshme.
4. I Licencuari do të publikoj Kodin e Sjelljes në faqen e tij elektronike zyrtare.

Neni 21: Rregullat e Tregut

Kushti 3:

ZRRE-ja mund të nxjerrë udhëzime për ta liruar të Licencuarin nga obligimet e parapara sipas këtij Neni në lidhje me ato pjesë të Rregullave të Tregut dhe në atë masë sa mund të specifikohen në këto udhëzime.

1. I Licencuari do të veproj në pajtim me Rregullat e Tregut për aq sa janë të zbatueshme

Neni 22: Shëndeti dhe Siguria

1. I Licencuari do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur personat dhe pronat nga lëndimet dhe dëmtimet që mund të shkaktohen nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së biznesit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit.
2. I Licencuari do të sigurojë që një ekspert i pavarur, emërimi i të cilit aprovohet nga ZRRE-ja do të kryen kontrollin teknik dhe të sigurisë së Sistemit të Transmisionit, në bazë vjetore.
3. I Licencuari duhet t'i dorëzojë ZRRE-së rezultatet e kontrollit të tillë brenda tre (3) muajsh nga kompletimi i tyre.

Neni 23: Puna

I Licencuari do të veprojë në pajtim me gjithë legjislacionin e aplikueshëm mbi marrëdhënie pune dhe sigurinë në punë që është në fuqi tani ose që do të hynë në fuqi në të ardhmen.

Neni 24: Obligimi i Sigurimit

Kushti 4:

I Licencuari do të veproj sipas kërkesës së caktuar me paragrafin 1 brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga data e lëshimit të kësaj licence.

1. I licencuari do të lidhë dhe mbaj në fuqi kontrata sigurimi për asetet e transmisionit dhe për pajisjet që përdoren për transmision. Kontrata e tillë do të dërgohet ZRRE për rishqyrtim në baza vjetore.

Neni 25: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritët në kontroll të të Licencuarit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE – ja nuk e aprovon atë.

Neni 26: Shërbimet Publike të Detyrueshme

I Licencuari do të pajtohet me çdo detyrim të shërbimeve publike që i ka vendosur ZRRE-ja, sipas Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 27: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do t'i dorëzojë informacione ZRRE-së, në mënyrën dhe në afatet siç mund ti konsideroi ZRRE-ja të nevojshme, duke marrë parasysh Nenet apo Kushtet e kësaj Licence, ose për qëllim të kryerjes së funksioneve që i janë caktuar ose transferuar atij sipas Nenit 29 të Rregullit për Liçencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë apo Legjislacionit tjetër të aplikueshëm.
2. Informacionet do të përgatiten në nivelin e auditimit si mund të kërkohen kohë pas kohe nga ZRRE-ja.
3. Kompetenca e ZRRE-së që të kërkoj informata sipas paragrafit 1 nuk e cenon kompetencën e ZRRE-së që të kërkoj edhe informata që konsiderohen si konfidenciale sipas çdo Neni apo Kushti të kësaj licence apo sipas Legjislacionit të aplikueshëm.
4. Nëse i Licencuari kërkon që ndonjë informatë të konsiderohet si konfidencial, ai ka për obligim që të shënoj informatën e tillë si konfidenciale dhe të arsyetoj kërkesën e tij tek ZRRE.
5. I Licencuari do të dërgoj ZRRE-së raportet tremujore dhe vjetor me të cilët informon mbi veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmisionit si dhe pajtueshmërinë me kushtet e Licencës sipas Doracakut të Raportimit lëshuar nga ZRRE.
6. I Licencuari do të dërgoj ZRRE-së detalet e çdo ndryshimi të informacioneve në material që janë dorëzuar me aplikacionin për këtë licencë.
7. I Licencuari duhet të dërgojë ZRRE-së raport vjetor mbi statusin e pajisjeve kryesore dhe kalkulimin e furnizimit të vazhdueshëm i cili do të përfshijë por duke mos u kufizuar vetëm në:
 - a) çmimet e shtuara apo të zvogëluara;
 - b) pagesat e detyrimeve;
 - c) parashikimet e kërkesës;
 - d) detajet e konsumit;

- e) profilet e kërkesës së Sistemit.

8. Në këtë Nen:

"Informacioni" është material në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

Neni 28: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës

1. ZRRE-ja mund të përfundojë këtë licencë në përputhje me Nenin 39 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë nëse obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të vijnë në pozitë të pa lakmueshëm për shkak të përfundimit të tillë. Përfundimi i tillë mund të ndërmirret në rast të:
 - a) skadimit të afatit të Licencës;
 - b) kërkesës së pranuar nga ndërmarrja e licencuar e energjisë lidhur me licencën e tij;
 - c) shpërbërjes së personit juridik që mban licencën;
 - d) pas vendimit të gjykatës me të cilin shpall falimentimin e të licencuarit apo vendimit të gjykatës për përfundimin e aktiviteteve të energjisë për shkak të shpalljes së likuiditetit të të licencuarit;
 - e) nëse aktiviteti i licencuar nuk është ushtruar më shumë se gjashtë muaj, përpos kur ndërprerja e aktivitetit është bërë me miratimin e ZRRE-së;
 - f) nëse janë plotësuar kushtet nga dispozitat e Nenit 44 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
 - g) nëse shuma e caktuar e tarifës për këtë licencë nuk është paguar tridhjetë (30) ditë nga data e caktuar dhe ka mbetur e papaguar edhe për një periudhë tjetër prej tridhjetë (30) ditësh pas vërejtjes me shkrim të dhënë nga ZRRE-ja në lidhje me vonesën e pagesës me kusht që vërejtja nuk do të lëshohet më herët se data kur shuma është dashur të paguhet.
2. ZRRE-ja mund të tërheqë këtë licencë në rastet e paraqitura më poshtë si është përcaktuar në Nenin 44.5 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, në rast se detyrime të të Licencuarit do të kryhen prej një të Licencuari tjetër ose që konsumatorët nuk do të vijnë në pozitë të disfavorshme nga kjo tërheqje:
 - a) i Licencuari nuk i plotëson kushtet materiale të Neneve, kushtet apo obligimet nga licenca apo edhe i shkel ato, dhe se ai mosplotësim dhe ato shkelje nuk janë ndrequr brenda afatit të caktuar nga ZRRE, apo ka dëmtuar seriozisht kualitetin, sigurinë dhe seriozitetin e shërbimit që i Licencuari ishte i obliguar ta ofroj;
 - b) nëse gjatë monitorimit të licencës nga ZRRE gjenden dështime në përmbushjen e kërkesave administrative dhe se ato dështime nuk janë eliminuar brenda afatit të caktuar nga ZRRE;
 - c) i Licencuari prezanton informata materiale false në bazë të të cilave është dhënë licenca.
3. Në pajtim me Nenin 35 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë ZRRE mund ta modifikoj këtë licencë në rastet si në vijim:
 - a) me kërkesë të të Licencuarit,

- b) nëse nevojitet për të mbrojtur sistemin energjetik në Kosovë, në lidhje me sigurinë e furnizimit dhe sigurinë e jetës ose shëndetit të qytetarëve, ose për mbrojtjen e mjedisit;
- c) në mënyrë që t'u plotësohen kërkesat e reja të paraqitura në marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet vendore, rregulloret dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm;
- d) si sanksion për shkeljen e kushteve dhe konditave të licencës, sipas Nenit 44 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Neni 29: Masat dhe Gjobat Administrative

1. Në rast shkeljeje të ndonjë dispozite të Legjislacionit, Neni apo kushti të kësaj Licence apo instruksioneve dhënë të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca që sipas Nenit 56.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit për Masat dhe Gjobat Administrative ta parandaloj të Licencuarin që ti përsëris veprimet ilegale apo në rast se veprimi është ndalur, ZRRE mund të lëshoj vendim rregullativ me të cilin kërkohet që të ndërmerren veprime konkrete apo ta ngarkoj me gjoba administrative të licencuarin dhe/apo anëtarin e Bordit të Drejtorëve dhe/apo ekzekutivin e saj.
2. Para se të jepet gjoba ZRRE do ti lëshoj të licencuarit një njoftim mbi shkeljet e bëra dhe do ti ofroj mundësi që brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga data e pranimit të njoftimit të përgjigjet me shkrim për të përmirësuar shkeljen.
3. Gjoba do ti ngarkohet të Licencuarit në pajtim me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullin për Masat Administrative dhe Gjobat nëse i Licencuari shkel dispozitat e ati Neni derisa ato janë të aplikueshme për të Licencuarin.
4. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Rregullin për Gjobat dhe Masat Administrative. Sidoqoftë nëse gjoba nga paragrafi 3 i ngarkohet të Licencuarit ajo nuk mund ta tejkaloj 15% e bruto të ardhurat e të Licencuarit nga veprimtaria e ushtruar sipas kësaj licence në vitin financiar paraprak.
5. Nëse gjoba nga paragrafi 3 i është ngarkuar anëtarit të Bordit të Drejtorëve apo ekzekutivit të të Licencuarit ajo nuk duhet të tejkaloj 300% e pagës mujore që ai person ka pranuar nga i Licencuari.
6. Në rast të përsëritjes së shkeljes, gjoba e ngarkuar mund të jetë 3 herë më e lartë se shuma e autorizuar me paragrafin 4 apo 5.
7. Gjatë ngarkimit të gjobës, në pajtim me këtë Nen, ZRRE do ta ketë parasysh shkallën e dëmtimit social nga ai veprim, sjelljet e përparshme të të Licencuarit apo personit si dhe gjendjen financiare të të Licencuarit apo personit.
8. Nëse gjoba e ngarkuar nga ZRRE-ja nuk është paguar, ZRRE do të inicioj procedurën gjyqësore për të marr gjobën si borxh civil.

Neni 30: Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja

2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me modifikimin, tërheqjen apo përfundimin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të apelojnë nga i Licencuari në gjykatën kompetente.